

VENDIM
Nr. 495, datë 21.7.2022

PËR RIORGANIZIMIN E RRETHEVE GJYQËSORE DHE KOMPETENCAVE
TOKËSORE TË GJYKATAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 13, të ligjit nr.98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm riorganizohen në 13 (trembëdhjetë) gjykata të rretheve gjyqësore me kompetenca tokësore, si më poshtë vijon:

a) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me seli në qytetin e Beratit dhe kompetencë tokësore në bashkitë Berat, Dimal, Kuçovë, Skrapar dhe Poliçan;

b) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, me seli në qytetin e Peshkopisë dhe kompetencë tokësore në bashkitë Dibër, Bulqizë, Mat dhe Klos;

c) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me seli në qytetin e Durrësit dhe kompetencë tokësore në bashkitë Durrës, Shijak, Kavajë dhe Rrogozhinë;

ç) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me seli në qytetin e Elbasanit dhe kompetencë tokësore në bashkitë Elbasan, Cërrik, Belsh, Peqin, Gramsh, Librazhd dhe Përrenjas;

d) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me seli në qytetin e Fierit dhe kompetencë tokësore në bashkitë Fier, Patos, Roskovec, Lushnjë, Divjakë dhe Mallakastër;

dh) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, me seli në qytetin e Gjirokastrës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Gjirokastrë, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë dhe Dropull;

e) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me seli në qytetin e Lezhës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Lezhë, Mirditë dhe Kurbin;

ë) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me seli në qytetin e Korçës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Korçë, Maliq, Pustec, Kolonjë, Devoll dhe Pogradec;

f) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, me seli në qytetin e Kukësit dhe kompetencë tokësore në bashkitë Kukës, Has dhe Tropojë;

g) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, me seli në qytetin e Sarandës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Sarandë, Konispol, Finiq dhe Delvinë;

gj) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me seli në qytetin e Shkodrës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë-Arës;

h) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me seli në qytetin e Tiranës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Tiranë, Kamzë, Vorë dhe Krujë;

i) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me seli në qytetin e Vlorës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Vlorë, Selenicë dhe Himarë.

2. Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm riorganizohen në një Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm, që organizohet dhe funksionon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në qytetin e Tiranës.

3. Gjykatat administrative të shkallës së parë riorganizohen në 2 (dy) gjykata administrative të shkallës së parë me kompetenca tokësore, si më poshtë vijon:

a) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me seli në qytetin e Tiranës dhe kompetencë tokësore, që përfshin rrethet gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Dibër,

Elbasan, Lezhë dhe Korçë;

b) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë, me seli në qytetin e Lushnjës dhe kompetencë tokësore, që përfshin rrethet gjyqësore Berat, Fier, Gjirokastrë, Sarandë dhe Vlorë.

4. Ngarkohen Këshilli i Lartë Gjyqësor, Prokurori i Përgjithshëm dhe Ministria e Drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) Riorganizimi i gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, sipas pikës 1, të këtij vendimi, më 1.5.2023;

b) Riorganizimi i gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, sipas pikës 2, të këtij vendimi, më 1.2.2023;

c) Riorganizimi i gjykatave administrative të shkallës së parë, sipas pikës 3, të këtij vendimi, më 1.7.2023.

KRYEMINISTËR

Edi Rama